



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 346

Datë: 12.09.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika d, nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit nr.03/040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17, dhjetor 2012), nenit 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët, ("Gazeta zyrtare Nr.16/01 Shtator 2007"), nenit 3 në lidhje me plotësimin dhe ndryshimin e nenit 5 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr.03/L-120 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.46/15 Janar 2009") për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr.2003/11, nenin 19, nenit 46 të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e dytë të mbledhjes së -IX- të mbajtur me datë: 07.09.2018 merr këtë:


V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës rikonfirmon vendimin nr.02/274 datë:13.07.2018 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë:13.07.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale KEDS-it në fshatin Terpezë për qëllime të infrastrukturës energjetike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës përmes organeve kompetente.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL - <i>[Signature]</i> Datë 16.07.2018 Nr. 020-860
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Malishevës
Lloji i aktit	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02-274 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme KEDS-it për qëllime të infrastrukturës energjetike
I miratuar më datë më datë: 13.07.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 16.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 02-274 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme KEDS-it për qëllime të infrastrukturës energjetike.	Ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Në bazë të certifikatës së pronësisë, me numër P-72310075-03249-0, evidentohet si Pasuri Shoqërore-Rrugët dhe si e tillë nuk është pronë e Komunës së Malishevës. Bazuar në këtë, dhe duke ju referuar ligjit të lartshënuar, komuna nuk mund të japë në shfrytëzim pronën e paluajtshme e cila nuk është në pronësi të sajë.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës


Nr.02/274

Datë: 16.07.2018

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2, pika d, nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit nr.03/040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17, dhjetor 2012), nenit 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 19, nenit 46 të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VIII (tetë) të mbajtur me datë: 13.07.2018 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa nr.01/1022 e datës: 09.07.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale në fshatin Terpezë për qëllime të infrastrukturës energjetike.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi prona e paluajtshme do t'i jepet në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike Sha.a (KEDS) pa procedurë konkurrimi.
3. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim gjendet në Zonën Kadastrale në fshatin Tërpezë, njësia kadastrale nr.P-72310075-03249-0 vendi i quajtur shpatiras-rruga Orlat, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 12580 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9 m², e evidentuar si pronë shoqërore Rrugët.
4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar sipas pikës 2 të këtij vendimi është, ndërtimi i objekteve- trafostacioneve elektorenergjetike 10(20)0.4kV, 160 kva.
5. Afati kohor i dhënies së pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 30 (tridhjetë) vjet dhe jepet pa kompensim.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Malishevës dhe si e tillë nuk mund t'i jepet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër.
7. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë të veçantë e cila do të nënshkruhet në mes Kryetarit të Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.



8. Prona e paluajtshme Komunale që jepet në shfrytëzim duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

9. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.

10. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim pronëso-ro-juridik.

11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Zyra e Kryetarit të Komunës

01/ *1022*

Dt.09.07.2018

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Rrahim Morina.

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës
Ragip Begaj.

Kopje : Arkivit të Komunës

Datë: 09.07.2018

LËNDA: Plotësim i kërkesës nr.01/727, dt.18.05.2018, në lidhje me shqyrtimin he marrjen e vendimit në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës publike në fshatin Tërpezë, KK-Malishevës, për qëllime të infrastrukturës energjetike.



Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Me datë 26.03.2018, institucionet e Komunës së Malishevës, kanë pranuar kërkesën Nr.2714, nga Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS), me anë të së cilës ka kërkuar që t'i jepet në shfrytëzim pa pagesë pjesa prej 9 m², nga pjesa e ngastrës me Nr.P -72310075-03249-0, e cila evidentohet si pronë shoqërore në emër të P.Sh. Rrugët, Zona Kadastrale Tërpezë, vendi i quajtur "Shpatiras – Rruga", KK-Malishevës.

-Në bazë të dispozitave ligjore, është proceduar për Kuvendin e Komunës së Malishevës, kërkesa nr.01/727, dt.18.05.2018, për procedimin e kërkesës së lartcekur.

Komiteti Për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të njëjtës ka kërkuar plotësimin e kërkesës në fjalë, duke propozuar caktimin- kohëzgjatjen e dhënies në shfrytëzim si dhe mënyrën e dhënies në shfrytëzim afatgjatë pjesën e ngastrës së lartcekur.

Në lidhje me këtë ne plotësojmë kërkesën e parashtruar sipas kërkesave parashtruara nga Komitetit Politikë dhe Financa, me arsyetimin e cekur si më poshtë;

Kërkesa është bërë për arsye të ndërtimit të objekteve – trafostacioneve elektroenergjetike 10 (20) /0.4 kV, 160 kva, i cili ndërtim do të përmirësojë dukshëm dhe në mënyrë kualitative furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në këtë lokacion. Sipas informacioneve që kemi, në fshatin Tërpezë rrjeti energjetik është mjaft i vjetër dhe ka probleme teknike, me prishje dhe ndërprerje të energjisë elektrike.

Prandaj duke parë nevojat e fshatit Tërpezë, si dhe mundësit që ka krijuar KEDS, kërkoj nga titulli i lartshënuar që pas shqyrtimit të dokumenteve përcjellëse të kësaj kërrese, arsyeshmërisë së investimit, me anë të vendimit të miratohet ndarja e sipërfaqes së kërkuar, dhënia në shfrytëzim e kësaj pjesës së ngastrës 03249-0, **në kohëzgjatje prej 30 viteve pa kompensim** për Kompaninë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a – Distrikti Prishtinë, pa të drejtë të bartjes së pronësisë.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,

Data:	23.03.2018
Për:	Drejtorinë e Pronës, Kadastër dhe Gjeodezi - Glogovc <i>Malik</i>
Nga:	DIVIZIONI I SHPËRNDARJES DISTRIKTI I PRISHTINËS
Tema:	KËRKESË PËR DHËNJËN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SHOQËRORE
Lënda:	Plane investive 2018
Lokacioni për vendosjen e trafostacionit të ri	Tërpezë-trafa e vjetër-Llapushnik

PRISHTINË

ACCOUNTING

PRISHTINË

Nr. Nënsh.

27-03-2018

06/12

Me që jemi në fazën e fillimit të punëve me "Plane Investive 2018", për ndërtimin e objekteve – trafostacioneve elektroenergjetike 10(20)/0.4 kV/kV të tensionit të ulët për projektin "Tërpezë-trafa e vjetër-Llapushnik" andaj kërkojmë nga titulli i lartëshënuar që të jep lejen e shfrytëzimit të pronës shoqërore(rrugë) për:

1. Vendosijen e trafostacionit të tipit shtyllë 10(20)/0.4kV 150kVA në hapësirën prej 9[m²]-në shfrytëzim pa kompensim, në kuadër të koordinatave:

X: 7486124.465

Y: 4709115.189, ZK Tërpezë(rrugë)

Besojmë se kërkesa jonë do të shqyrtohet në afat sa më të shpejtë, sepse ndërtimi i këtyre objekteve elektroenergjetike do të përmirësoj dukshëm dhe në mënyrë kualitative furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në këto lagje.

Të bashkangjitur gjeni:

1. Projektin kryesor me nr. 2646, dt. 22.03.2018
2. Fletat poseduese dhe kopjet e planit

Nr. kontaktues janë edhe : 049-790-431, 049-790-341

Me respekt,

Inxhinier i Rrjetit :

Sabiha Demaj


Burbuqe Baruti

Inxhinier i Prishjeve:

Ali Ibishi

Drejtor i Distriktit, Prishtinë

Milazim Avdiu





Sipas Pikës (d) të Autorizimit të datës 24 Maj 2013 të dhënë nga Drejtori Gjeneral dhe Zytari Kryesor Financiar/Drejtori Financiar në përputhje me Pikën 38 të Nenit 9.8 të Statutit të Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. ('KEDS') të datës 29 Prill 2013, në cilësinë e Drejtorit për Investime në Divizionin e Rrjetit KEDS Sh.a. lëshojë, këtë:

AUTORIZIM

Duke autorizuar,

1. Burbuqe Baruti , me nr personal 1004141233

2. Sabiha Demaj , me nr personal 1010684001,


të punësuar në Kompaninë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a Prishtinë – Distrikti Prishtinë, do të përfaqësojnë KEDS_in, duke i marrë të gjitha veprimet e nevojshme pranë të gjitha Organeve Komunale, Ministrive përkatëse në Qeverinë e Kosovës për:

- tërheqjen e të gjitha dokumenteve nga organet komunale – Ministrive përkatëse në emër të KEDS Sh.a. si fletëposeduese & kopje të planit,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për vendosjen e Stabilimenteve Energjetike - TS 10(20)/0.4kV,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për ndërtimin e kanaleve kabllovike për vendosjen e Linjave kabllovike të TM 10(20)/0.4kV dhe TU 0.4kV,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për ndërtimin e pusetave,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për vendosjen e shtyllave të TM 10(20)/0.4kV dhe TU 0.4kV,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për prerjen e asfaltit,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për prerjen e drunjëve,
- sigurimin e Lejeve(Pëlqimeve) për largimin e kubëzave të betonit,
- etj.

Autorizimi vlen nga data 05.02.2018 e deri më 31.12.2018

Drejtori i Investimeve në Divizionin e Rrjetit- KEDS Sh a

Hasan OZ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDITIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310075-03249-0

Numri i llogdës / Broj Predmet / Case Referent Number: 810-2018
Të dhëna dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 27.03.2018 - 13:15
Zona / Opština / Municipality: Malishevë / Mališevo / Malishevë
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: TËRPEZË / TRPEZA / TËRPEZË
Zona Kadastrale Komunele / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Malishevë / Mališevo / Malishevë

TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72310075-03249-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Inovina / Socially owned Land		12580			

ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Podatnosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SHIPATIRAS-RRUGA ORLAT/SHIPATIRAS-RRUGA ORLAT/SHIPATIRAS-RRUGA ORLAT		SHIPATIRAS-RRUGA ORLAT		

2. LLOJTI SHIFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Idri / Parcel Number	Lloji i shifrytëzimit të parcelës / Vrstja koriscenja parcele / Parcel Type Of Use	Shifrytëzimi aktual i parcelës / Trenutno koriscenje parcele / Parcel Current Use	Kualiteti i klasës / Kvalitet klase / Quality Class	Sipërfaqja / Poveršina / Area (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakelegor/Nekategorisani Put/Uneategorized Road		12580

PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat / Prava / Rights	Emri i Ime / Name	Nr. personali / Licent broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebivalište / Resident	Kodi postar / Poštanski kod / Postal code	Hollësitë e adresës / Pojednostni adresac / Address details	Pjesa e pronës / Doo imovine / Share quota	Pershkrimi / Opis / Description	Azhuruar / Azuritano / Updated
sedini individual / dividualna Drazvina / iple possessor	P.SH.RRUGËT	KCID2300098	TËRPEZË / TRPEZA / TËRPEZË /			1/1		

Për: Kuvendin Komunal Malishevë - Kryetarin Ragip Begaj

Nga: Kryesia e Fshatit Tërpezë – Kryetari Afrim Krasniqi

16-04-2018

01-572



Kryesia e Fshatit Tërpezë ka mbajtur mbledhjen e radhës më datë 14.04.2018, në të cilën mbledhje është diskutuar në lidhje me projektin e Kompanisë KEDS, për investimet në rrjetin e ri energjetik dhe në trafo, punë e cila do të kryhet në lagjet nga shkolla fillore e lartë. Duke marrë parasysh problemet me të cilat përballemi ne si fshat, me ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike japim këtë:




P Ë L Q I M

Ne, si kryesi e fshatit kemi njoftuar banortë e fshatit në lidhje me investimet që do të bëhen nga KEDS, në ndërrimin e rrjetit elektrik si dhe vendosjen edhe të një trafos shtesë për përmisimin e gjendjes së energjisë elektrike. Ky investim është i domosdoshëm sepse tashme që nga paslufta përballemi me ndërprerje të energjisë elektrike si pasojë e rrjetit shumë të vjetër.

Prandaj, së bashku me këtë pelqim, me kërkesën e KEDS-it, kërkojmë nga Kryetari që ta procedojë këtë çështje në Kuvendin Komunal.

KRYESIA E FSHATIT TËRPEZË

1. Afrim Krasniqi, 
2. Salih Krasniqi, 
3. Arton Bytyqi, 
4. Misin Krasniqi, 

5. Gazmend Krasniqi, 
6. Liridon Krasniqi, 
7. Brahim Krasniqi, 


KOPJE PLANI / COPY OF PLAN

Zona Kadastrale / Cadastral Zone: Terpezë

Parcela nr. / Parcel Nr: 87-1 dhe 87-2

Pronari, Shfrytëzuesi / Owner, Possessor:

Fletëposedimi nr. / Possession list Nr:



Data: 27/03/2018

Stamp and signature area. The stamp is circular and contains the text "DIREKTORIA E KADASTRIT". Below the stamp is a handwritten signature and the text "E punoi / Operator".